

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“Albcolom Construction” SH.P.K.  
DATË 17.10.2024**

Sot, në datën 17.10.2024, z. Juan Manuel CIRO MARIN, shtetas shqiptar, lindur më 13.12.1973, në Kolumbi, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H31213133T në cilësinë e Ortakut te vetem Themelues, vendosi të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar “Albcolom Construction” Sh.p.k. Kjo shoqëri do të realizojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin, i cili i bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi.

**NENI 1 – EMËRTIMI**

- 1.1 Shoqëria emërtohet “Albcolom Construction” Sh.p.k. (në vijim “Shoqëria”).

**NENI 2 – FORMA**

- 2.1 Shoqëria “Albcolom Construction” Sh.p.k themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.
- 2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

**NENI 3 – SELIA**

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën Rruga Muharem Sheshi Nr. 7 Hyrja 1, Fshati Goskove Poshtë. Kodi Postal 7026, Njesia Administrative Voskop, Korçë, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci në adresat tjetra si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 3.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresat sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.

**NENI 4 – OBJEKTI**

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston në kryerjen e aktivitetave të përcaktuara më poshtë:
- Realizimi i veprimtarive ekonomike në fushën e ndërtimit të objekteve civile dhe/ose industriale, zbatimi i punimeve në ndërtim;
  - Realizimi i punimeve te ndërtimit dhe mirembajtjes se rrugeve, kanaleve, hapje dhe germime boshtesh ndertimi.

*Juan M. Ciro M*

- c. Realizimi i punimeve parafabrikim konstruksionesh dhe tubacione ne per gjithesi.
- d. Furnizimi me personel te kualifikuar dhe te pakualifikuar , makineri te renda ne fushen e ndertimit,
- e. Import – eksport dhe/ose përpunim i materialeve të ndërtimit, Prodhimi dhe shitje me shumicë dhe pakicë e materialeve të ndërtimit, lëndëve të para në ndërtim.

#### **NENI 5 – KOHËZGJATJA**

- 5.1 Shoqëria themelohet me një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **NENI 6 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT**

- 6.1. Kapitali i Shoqërisë është 100 ALL (njëqind lekë), i përbërë nga 1 (nje) kuote.
- 6.2. Kapitali është nënshkruar dhe shlyer tërësisht si me poshtë vijon:  
**Z. Juan Manuel CIRO MARIN**, i cili ka shlyer kontributin ne Shoqëri, ne para ne shumen e barabarte me: 100 Leke (njeqind leke);
- 6.3. Bazuar ne kontributet e cituara me sipër:
  - **Z. Juan Manuel CIRO MARIN**, zoteron një kuote te barabarte me 100% (njeqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe
- 6.4. Ortakëtë Shoqërisë përgjigjen për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të saj.

#### **NENI 7 – TRANSFERIMI I KUOTAVE**

- 7.1 Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në Statutit e Shoqërisë.

#### **NENI 8 – ADMINISTRATORI/ËT**

- 8.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojë/në në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjeter.
- 8.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe çdo rast në zbatim të kufijve të përcaktuar në aktin e emërimit të tij dhe/ose në Statutin e Shoqërisë.
- 8.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë të posaçme (“*ad negotia*”) për kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave

*Juan M. Ciro M.*

që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.

8.4 Caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:

**Juan Manuel CIRO MARIN**, shtetas shqiptar, lindur më 13.12.1973, në Kolumbi, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H31213133T madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.”

#### **NENI 9 – GJUHA**

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

#### **NENI 10 – DISPOZITA TË FUNDIT**

10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt - Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjisacionit shqiptar.

ORTAKU THEMELUES

**Juan Manuel CIRO MARIN**

*Juan Manuel Ciro Marin*  
*Juan M. Ciro M.*

**STATUTI I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Albcolom Construction” SH.P.K.**  
**DATË 17.10.2024**

Sot, në datën 17.10.2024, z. Juan Manuel CIRO MARIN, shtetas shqiptar, lindur më 13.12.1973, në Kolumbi, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H31213133T në cilësinë e Ortakut te vetem Themelues, vendosi të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar “Albcolom Construction” Sh.p.k bazuar ne statutin si me poshte.

**KAPITULLI I**  
**EMËRTIMI, FORMA, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA**

**NENI 1 – EMËRTIMI DHE FORMA E SHOQËRISË**

- 1.1 Shoqëria emërtohet “Albcolom Construction” SH.P.K (në vijim “Shoqëria”).
- 1.2 Shoqëria “Albcolom Construction” SH.P.K themelohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe rregullohet me anë të këtij Statuti, Akitit të Themelimit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**NENI 2 – SELIA**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën Rruga Muharem Sheshi Nr. 7 Hyrja 1 , Fshati Goskove Poshtë. Kodi Postal 7026, Njesia Administrative Voskop, Korçë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresë sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.

**NENI 3 – OBJEKTI**

- 3.1 Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara më poshtë:
  - a. Realizimi i veprimtarive ekonomike në fushën e ndërtimit të objekteve civile dhe/ose industriale, zbatimi i punimeve në ndërtim;
  - b. Realizimi i punimeve te ndertimit dhe mirembajtjes se rrugeve, kanaleve, hapje dhe germime boshtesh ndërtimi.
  - c. Realizimi i punimeve parafabrikim konstruksionesh dhe tubacione ne pergjithesi.
  - d. Furnizimi me personel te kualifikuar dhe te pakualifikuar , makineri te renda ne fushen e ndertimit.

Juan M. Giro M.

- e. Import – eksport dhe/ose përpunim i materialeve të ndërtimit, Prodhimi dhe shitje me shumicë dhe pakicë e materialeve të ndërtimit, lëndëve të para në ndërtim.
- 3.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksiioni tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, përfshirë edhe huamarrje/ huadhënie, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### **NENI 4 – KOHËZGJATJA**

- 4.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 4.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### **KAPITULLI II KAPITALI, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË**

#### **NENI 5 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT**

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100 ALL (njëqind lekë), i përbërë nga 1 (nje) kuote.
- 5.2 Kapitali është nënshkruar dhe shlyer tërësisht si me poshtë vijon:
- Z. Juan Manuel CIRO MARIN, i cili ka shlyer kontributin ne Shoqëri, ne para ne shumen e barabarte me: 100 Leke (njeqind leke);
- 5.3 Bazuar ne kontributet e cituara me sipër:
- Z. Juan Manuel CIRO MARIN, zotëron një kuote te barabarte me 100% (njeqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe
- 5.4 Ortakëtë Shoqërisë përgjigjen për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të saj.

#### **NENI 6 – ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË**

- 6.1 Rritja e kapitalit mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, pa kufizim, përmes kontributit në para apo në natyrë apo me kredi, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi dhe Statutit të Shoqërisë.
- 6.2 Rritja e kapitalit konsiderohet e kryhet në momentin kur kuotat e emetuara dhe të nënshkruara më parë janë shlyer tërësisht.

*Juan M. Ciro M.*

- 6.3. Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të Asamblesësë Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqidhe Statutit të Shoqërisë. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e parashikuar me ligj.
- 6.4. Zvogëlimi i kapitalit mbartet prej secilit ortak proporcionalisht me kuotat që ai ka në kapitalin e Shoqërisë.

#### NENI 7 – TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 7.1. E drejta e pronësisë mbi kuotat është lirisht e transferueshme tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- 7.2. Ne rast shoqeria do te kete me shume se një ortak, nqs njeri prej ortakeve ka qellim te shesë apo te transferoje një pjese apo te gjitha kuotat e tij ("Ofruesi"), ai duhet te njoftoje me shkrim paraprakisht ortaket e tjerë ("Ortaket e Tjerë"), me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi qëllimin për shitjen dhe ku përcakton (i) numrin e kuotave, (ii) çmimin për kuote dhe (iii) emrin e palës se trete blerëse ("Blerësi") ("Njoftimi I Transferimit"). Kushtet dhe afatet e tjera te transferimit për te cilat Ofruesi dhe Blerësi si pale e trete kane rene dakord nuk kane fuqi detyruese mbi Ortaket e Tjerë. E drejta e parablerjes i referohet te gjitha kuotave te ofruara për shitje ("Kuotat e Ofruara").
- 7.3. Brenda një afati prej 20 (njëzet) ditësh pune nga marrja e Njoftimit te Transferimit, Ortaket e Tjerë duhet t'i komunikojnë Ofruesit synimin e tyre për te ushtruar apo jo te drejtën e parablerjes. Ne rast se Ortaket e Tjerë nuk përgjigjen ne afatin e caktuar, do te konsiderohet qe ata kane hequr dore nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 7.4. Ne rast se vetëm disa nga Ortaket e Tjerë dëshirojnë te blejnë Kuotat e Ofruara, secili prej tyre ka te drejte te blejë Kuotat e Ofruara tërsisht ne përpjesëtim me kuotat qe zotëron ne Shoqëri.
- 7.5. Ne rast se te gjithë apo një pjese e Ortakeve te Tjerë ushtrojnë te drejtën e parablerjes ne mënyrën e sipërcituar, transferimi i Kuotave te Ofruara dhe pagesa e çmimit te blerjes do te behet sipas kushteve te Njoftimit te Transferimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pune nga përfundimi i afatit për ushtrimin e te drejtës se parablerjes përcaktuar ne statut.
- 7.6. Ne rast se asnjë apo një pjese e Ortakeve te Tjerë nuk blejnë Kuotat e Ofruara dhe/ose nuk pranojnë te blejnë Kuotat e Ofruara ne mënyrat e caktuara me lart, Ofruesi ka te drejte t'i transferoje Kuotat e Ofruara te panënskruara Blerësit ne përputhje me kushtet e Njoftimit te Transferimit. Transferimi i kuotave dhe pagesa e çmimit te shitjes do te behet ne përputhje me kushtet e Njoftimit te Transferimit dhe brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pune nga përfundimi i afatit për ushtrimin e te drejtës se parablerjes përcaktuar ne Nenin 7.3 me lart ("Afati i Mbylljes").
- Ne rast se transferimi i kuotave nuk kryhet brenda Afatit te Mbylljes ose do te kryhet ne kushte me pak te favorshme se ato te përcaktuara ne Njoftimin e Transferimit, Ofruesi do te jete i detyruar ta nise nga e para te gjithë procedurën e se drejtës se parablerjes.

Pvan M Givo M

7.7 Neni 7.2 dhe vijues nuk do te zbatohen ne rast transferimi te kuotave nga ortaku një tek shoqëritet e lidhura mete. Ne kuptim te këtij nenit Shoqëri te lidhura do te konsiderohen:

- (i) njëshoqëri qe direkt ose indirekt kontrollon ortakun ofrues;
- (ii) njëshoqëri qe kontrollohet direkt ose indirekt nga ortaku ofrues;
- (iii) ortaku ofrues dhe shoqëria qe do t'i transferohet kuota janë nen kontrollin e se njëjtës shoqëri;
- (iv) njëshoqëri qe është nen influencën e ortakut ofrues sipas nenit 207 te ligjit Nr. 9901 date 14. 03.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritet tregtare", i ndryshuar.

7.8 Ndalohet krijimi i të drejtave reale mbi kuotat e Shoqërisë me qëllim garantimin e detyrimeve të një palë të tretë, me ose pa pagesë, përveçse kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme parashikohet ndryshe.

### KAPITULLI III ASAMBLEJA E ORTAKËVE DHE ADMINISTRATORËT

#### NENI 8 – ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, TË DREJTAT E PJESËMARRJES DHE VOTËS, THIRRJA

- 8.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, në të cilën marrin pjessë të gjithë ortakët e Shoqërisë.
- 8.2 Secili ortak ka të drejtën të marrë pjessë në Asamblenë e Përgjithshme, të shpreh mendimin e tij dhe të votojë, në përputhje me përqindjen e zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë.
- 8.3 Secili ortak ka të drejtën të përfaqësohet nga një person tjetër, ortak dhe jo ortak, i pajisur me një prokurë të posaçme, përmes së cilës do të mund të shprehë votën e vet. Në çdo rast, prokura do të mund të lëshohet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Ortakëve dhe është e vlefshme për thirrjen e parë dhe të dytë të saj.
- 8.4 Ortaku nuk mund të japë prokurë vote për një pjessë të kuotës së zotëruar prej tij, nëse voton personalisht për një pjessë të saj.
- 8.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë në Shqipëri apo jashtë saj. Pranohet mundësia që Asambleja e Përgjithshmetë zhvillohet me video/telekonferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen, t'u mundësohet të ndjekin bisedën, të ndërhyjnë jalin mendimet e tyre në kohë reale lidhur me trajtimin e argumenteve dhe të votojnë në të njëjtën kohë mbi pikat e rendit të ditës. Pas verifikimit të elementeve të mësipërme, të cilat duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, mbledhja do të quhet e zhvilluar në vendin ku Kryetari i mbledhjes dhe Sekretari, njëkohësisht kanë qenë të pranishëm.
- 8.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret prej Administratorit/ve, në rastin kur është e nevojshme për interesat e Shoqërisë apo kur kërkohet nga ligji, sikurse

Puan M. giro M

edhe nga një apo më shumë ortakë të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit të Shoqërisë përmes një kërkesë të shkruar drejtar Administratorit/ve. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të mblidhet të paktën një herë në vit brenda muajit të gjashtë të vitit finanziar, me qëllim që të diskutojë, analizojë dhe miratojë bilancin vjetor, raportin e administratorit dhe të ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar).

- 8.7 Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret përmes një letre rekomande me kthim përgjigje apo me postë elektronike dërguar në adresën e tyre të banimit apo në adresën e tyre elektronike, të paktën 7 (shtatë) ditë përpëra ditës së përcaktuar për zhvillimin e Asamblesë.
- 8.8 Njoftimi duhet të përbajë rendin e ditës dhe të tregojë datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë dhe eventualisht edhe datën, vendin dhe orën e mbledhjes së dytë, nëse e para nuk arrin të mblidhet.
- 8.9 Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e thirrur në mënyrë të vlefshme dhe e mbledhur edhe nëse të gjitha formalitetet që kanë të bëjnë me thirrjen e saj nuk janë respektuar, me kusht që i gjithë kapitali i Shoqërisë të jetë i pranishëm apo i përfaqësuar me prokurë dhe që të gjithë ortakët të pranojnë të marrin vendim pavarësisht parregullsisë së thirrjes.
- 8.10 Nëse përbushen këto kushte, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e zhvilluar në vendin ku ndodhet Kryetari i mbledhjes dhe ku gjithashtu duhet të ndodhet edhe Sekretari, në mënyrë që të aprovojnë zbardhjen dhe nënshkrimin e proces - verbalit mbi librin përkatës.
- 8.11 Në thirrjen e mbledhjes së Asamblesë e Përgjithshme duhet të jenë të përcaktuar vendet, edhe jashtë selisë së Shoqërisë, të lidhur me video/telekonferencë nën kujdesin e Shoqërisë, ku ortakët do të mund të mblidhen.
- 8.12 Asambleja e Përgjithshme kryesoitet nga një Kryetar i emëruar nga ortakët e pranishëm apo të përfaqësuar në Asamble. Nëse prania e një noteri nuk është e kërkuar nga kuadri ligjore në fuqi, Asambleja zgjedh një Sekretar, i cili mund edhe të mos jetë ortak.
- 8.13 Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme ka të drejtë të plotë të verifikojë prokurat dhe vlefshmérinë e tyre, të drejtën e Përgjithshme dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamble dhe të vendosë nëse kjo e fundit është mbledhur në mënyrë të rregullt dhe nëse kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime është arritur vlefshmërisht. Kryetari ka edhe të drejtën të kryesojë bisedimet dhe të marrë vendime mbi rregullat dhe procedurat lidhur me votën.
- 8.14 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve të Asamblesë duhet të përgatiten menjëherë pas Asamblesë dhe duhet të nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblesë, sikurse edhe prej noterit, kur kjo kërcohët nga kuadri ligjor në fuqi. Lista e pjesëmarrësve i bashkëlidhet procesverbalit të mbledhjes si dhe çdo dokumentacion tjetër në lidhje me vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme. Administratori/ët, është/janë përgjegjës për mbajtjen e kopjes së dokumentacionit të sipërcituar.

Quan M. Civo M

## NENI 9 –KOMPETENCAT E ASAMBLESË DHE KUORUMI

9.1 Asambleja e Përgjithshme vendos mbi çështjet e mëposhtme:

- a. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- b. ndryshimi i statutit të Shoqërisë;
- c. transformimin, ndarjen, bashkimin, likuidimin ose prishjen e Shoqërisë, si dhe riorganizimin e saj në çdo formë tjetër;
- d. pjestimin e kuotave të Shoqërisë dhe anullimin e tyre;
- e. përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe planin strategjik të zhvillimit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga Administratori, përfshirë raportimet financiare;
- f. miratimin e buxhetit vjetor dhe planit të biznesit të Shoqërisë dhe çdo ndryshim të tyre;
- g. miratimin e pasyrave financiare në mbyllje të çdo viti ushtrimor dhe raportet e seurisë së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori;
- h. miratimin e shpërndarjes e fitimeve vjetore;
- i. miratimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm të Shoqërisë të hartuar nga Departamenti i Auditit në varësi të Ortakut të Vetëm;
- j. emërimin dhe shkarkimin e Administratorit dhe Drejtuesit/Menaxhët e lartë të Shoqërisë, si dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
- k. emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël dhe/ose likuiduesve dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
- l. miratimin e degëve dhe zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendimit;
- m. miratimin e themelimit të shoqërive të reja të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendit;
- n. miratimin e krijimit të Joint Ventures dhe bashkëpunimeve të cilit do lloji qofshin që kanë të bëjnë me investim, financim, fitim të drejtrash apo pjesëmarrjesh në projekte ekzistuese apo të reja;
- o. blerjen dhe shitjen e pjesëmarijeve në shoqëri të tjera, si dhe dhënien e kontributit në kapitalin e shoqërive të tjera;
- p. miratimin e kërkesave të reja dhe vendosjen për rinnovim të kërkesave ekzistuese për financim;
- q. vendosjen e barrëveve, hipotekës, pengut apo garanci të çdo lloji tjetër mbi pasuritë e Shoqërisë;
- r. dhënien e çdo garancie korporative ose nënshkrimin e çdo marrëveshje të tjetër për të siguruar përbashkët e detyrimeve financiare ose jo financiare ndaj të tretëve;
- s. shitjen e ndërmarrjes ose degëve të ndërmarrjes;
- t. shitjen, blerjen apo shkëmbimin e pasurive të paluajtshme dhe nënshkrimin e kontratave të sipërmarrjes në lidhje me to;
- u. akordimin e huave ose paradhënieve për Administratorët ose Drejtuesit/Menaxherët e lartë për nevoja personale;
- v. miratimin e rregullores/ve së brendshme të Shoqërisë;
- w. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.

9.2 Per çështjet e listuara ne vijim ("Vendimet e Jashtëzakonshme"):

- a. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;

Puan M. Ciro M

- b. ndryshimin e statutit te Shoqërisë;
- c. transformimin, ndarjen, bashkimin, likuidimin ose prishjen e Shoqërisë, si dhe riorganizimin e saj ne çdo forme tjeter;
- d. miratimin e buxhetit vjetor dhe plan biznesit te Shoqerise dhe çdo ndryshim te tyre;
- e. investimet dhe shpenzimet e paparashikuara ne buxhetin vjetor te Shoqërisëpërnjë vlere mbi 20% te çdozëri te planit final te biznes planit, ose 10% te vlerës totale te biznes planit;

9.3 Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime në mënyrë të vlefshme në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

- 9.4 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet me thirjen e parë përmungesën të Ortakut të Vetëm, Asambleja e Përgjithshme do të thirret sërisht brenda 7 (shtatë) ditësh me të njëtin rend dite.

#### **NENI 10 – ADMINISTRATORI/ËT**

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojë/në në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjeter.
- 10.2 Administratori/ët përfaqëson/jnë ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme. Administratori ka te drejte hartoje, formalizojë dhe komunikojë procedurat e brendshme, urdhërat dhe udhëzimet që duhet të dalin në zbatim të këtij Statutit dhe/ose rregulloreve të brendshme të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.
- 10.3 Administratori/ët mund të emërojë/në përfaqësues me prokurë të posaçme ("ad negotia") kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.
- 10.4 **Juan Manuel CIRO MARIN**, shtetas shqiptar, lindur më 13.12.1973, në Kolumbi, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H31213133T caktohet administrator i parë i shoqërisë.

#### **NENI 11 – EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR**

- 11.1 Nëse kërkohet nga ligji ose një vendim i tillë merret nga Asambleja e Përgjithshme, pasqyrat financiare dhe librat kontabël të Shoqërisë do të kontrollohen/ auditohen nga një apo më shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 11.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të revokohet në çdo çast në bazë të kushteve të përcaktuara nga legjislacionin në fuqi.

## **KAPITULLI IV** **VITI USHTRIMOR, PASQYRAT FINANCIARE VJETORE DHE** **SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

### **NENI 12 – VITI FINANCIAR DHE BILANCI VJETOR**

- 12.1 Viti ushtrimor fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
- 12.2 Viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe përfundon më 31 Dhjetor, të të njëjtit vit.
- 12.3 Pasqyrat financiare dhe raporti i ecurisë i hartuar prej Administratori dhe raporti që hartohet nga eksperti kontabël i emëruar (në rast se është emëruar një i tillë), miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 12.4 Miratimi i dokumenteve lidhur me vitin ushtrimor duhet të kryhet brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i këtij vitit.

### **NENI 13 – FITIMET**

- 13.1 Fitimet neto që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore, i shpërndahen Ortakëve në përpjesët im me pjesët takuese të tyre në kapitalin e Shoqërisë.
- 13.2 Asambleja, gjithashtu, mund të vendllojë mbajë shuma të caktuara si rezerva, apo të shtyjë shpërndarjen e fitimeve, tërësisht apo pjesërisht për vitin/et ushtrimore pasardhës.

## **KAPITULLI V** **SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

### **NENI 14 – SHPËRNDARJA**

- 14.1 Shoqëria shpërndahet në përfundim të afatit të saj parashikuar në Statut apo edhe përpara këtij afati, në rastet e parashikuar nga ligji apo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e parashikuar për ndryshimin e Statutit të Shoqërisë.
- 14.2 Shoqëria nuk shpërndahet në rast paaftësie, vdekjeje apo falimentimi të ortakëve.

### **NENI 15 – LIKUIDIMI**

*Ruan M Civo M*

- 15.1 Në rast shpërndarjeje Shoqëria do të kalojë në likuidim
- 15.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar mbi gjendjen e pasivit dhe aktivit të Shoqërisë, mbi veprimet e likuidimit dhe kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 15.3 Në përfundim të procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të marrë vendim në lidhje me bilancin finansiar përfundimtar, mbi vlefshmërinë e punës së kryer prej likuidatorit dhe mbi përfundimin e procedurës së likuidimit.
- 15.4 Pas kryerjes së pagesës së kreditorëve/ëve dhe têrheqjes së kredive, likuidatori/ët do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit tek ortakët, proporcionalisht me kuotat që ata respektivisht kanë në kapitalin e Shoqërisë.

## KAPITULLI VI DISPOZITA TË FUNDIT

### NENI 16 – ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 16.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtyre dispozitave të këtij Statuti, midis ortakëve ose midis një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen me marrëveshje mes palëve. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje me marrëveshje, palët mund t'i drejtohen Gjykatës së Shkalles se pare te Juridiksonit te Pergjithshem Korçë.

### NENI 17 – DISPOZITAT LIGJORE NË FUQI

- 17.1 Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.

**Miratuar nga:**  
 ORTAKU THEMELUES  
**Juan Manuel CIRO MARIN**  
*Juan Manuel Ciro Marin*  
*Juan M. Ciro M.*